



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VII-të për vitin 2011, e Kuvendit Komunal në Vushtri, mbajtur më 28.7.2011

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë.

Para fillimit të punimeve të seancës së Kuvendit, u mbajt një minut heshtje për nderim të rënies heroike të policit të njësisë speciale, Enver Zymerit.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- parashtroi që në rend dite të futet “Deklarata në mbështetje të qëndrimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me pjesën veriore të Kosovës”.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së e mbështeti propozimin që të futet një deklaratë e përbashkët. Pastaj propozoi të futet në rend dite ndarja e një ndihme financiare për dëshmorin më të ri, Enver Zymeri. Tutje kërkoi që pika nr. 2 të shtyhet për mbledhjen e ardhshme dhe të vijë si raport, dhe po ashtu kërkoi që të shtyhet edhe pika nr. 5, në mënyrë që të jetë informatë e kompletuar për periudhën 6-mujore.

Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit- e mbështeti propozimin për nxjerrjen e deklaratës rreth gjendjes në veriun e Kosovës. Pastaj tha se siç po duket KPF-ja është vetëm formale, kurse në fakt është një filtër shumë me rëndësi, pasi që shqyrton çështje strategjike për komunën në përgjithësi, dhe ka shqyrtuar edhe në rastin

konkret por mungojnë këshillat, prandaj është e rrugës që çdo material të kalojë përmes KPF-së. Mandej duke iu referuar pikës nr. 2 të rendit të ditës, tha se ligji e obligon kryetarin e komunës që të kumtojë para Kuvendit për situatën ekonomike-financiare, për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku një herë në 6 muaj, ose kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës. Bazuar në këtë ai propozoi që të vijë raporti me shkrim me të gjitha elementet e nevojshme që pasqyrojnë gjendjen e përgjithshme të mjeteve dhe gjendjes së atyre projekteve.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- propozoi që të ecet përpara me rendin e ditës ashtu siç ka ardhur. Kurse në “të ndryshme” propozoi që të trajtohen punimet lidhur me Kullën e Azem Galicës, meqenëse punimet janë ndërprerë dhe nuk janë duke ecur mirë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të PDK-së kërkoi që pika nr. 2 e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, pasi që mungon materiali për këtë pikë. Gjithashtu ai mbështeti propozimin për nxjerrjen e një deklarate lidhur me gjendjen në veriun e Kosovës, dhe tri pikat që kanë ardhur për shqyrtim në “të ndryshme”.

Ferit Driziqi, kryesues i Kuvendit- tha se u kërkua që pika nr. 2 e rendit të ditës të hiqet, dhe të vijë në mbledhjen e ardhshme. Pastaj hyjnë në rend dite: nxjerrja e një deklarate në mbështetje të qëndrimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me gjendjen në veriun e Kosovës, propozimi për t’i dhënë një ndihmë financiare familjes së heroit të Kosovës Enver Zymerit. Kurse pika nr. 5 të riformulohet: “Shqyrtimi i informatës lidhur me të hyrat komunale janar-qershor 2011”. Ndërsa në të ndryshme hyjnë:

- a. Propozim-vendimi nga Drejtoria për Shërbime Publike;
- b. Kërkesë nga Drejtoria e Arsimit për bartjen e nxënësve në shkollat amë;
- c. Propozim-vendimi nga Drejtoria për Shëndetësi për ndihmë financiare ish-pjesëtarit të UÇK-së, Ekrem Shabani;
- ç. Shqyrtimi i ecurisë së punimeve në Kullën e Azem Galicës.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi në mënyrë unanime miratoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e KK-së, mbajtur më 28.07.2011.
2. Nxjerrja e Deklaratës në mbështetje të qëndrimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me gjendjen në veriun e Kosovës.
3. Shqyrtimi i propozimit për ndihmë financiare për familjen e heroit të Kosovës, Enver Zymerit.
4. Shqyrtimi i kërkesës së NTP “Agri-Production” për vazhdim të kontratës.
5. Shqyrtimi i raportit final i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të komunës për vitin 2010.
6. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2012 (shqyrtimi i parë).
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me të hyrat komunale janar-qershor 2011.
8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të procesit mësimor për vitin shkollor 2010/2011.
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartje të mjeteve nga mbetjet e projekteve kapitale të tenderuara të DSHMS-së.
10. Shqyrtimi i raportit të komisionit lidhur me peticionin e banorëve të fshatit Begaj, nr. 534/11, dt. 09.06.2011, në lidhje me kundërmimin e varrezave të qytetit në fshatin në fjalë.
11. Të ndryshme:

- a. Propozim-vendimi që obligon bizneset për kryerjen e borxheve ndaj KRM-së "Uniteti", me rastin e aplikimit për leje të biznesit;
- b. Kërkesë nga Drejtoria e Arsimit për bartjen e nxënësve në shkollat amë;
- c. Propozim-vendimi për ndihmë financiare ish-pjesëtarit të UÇK-së, Ekrem Shabani;
- ç. Shqyrtimi i ecurisë së punimeve në Kullën e Azem Bejtë Galicës.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e KK-së, mbajtur më 28.07.2011.

Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes paraprake të Kuvendit të Komunës, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Nxjerrja e Deklaratës në mbështetje të qëndrimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me gjendjen në veriun e Kosovës.

Aprovohet në mënyrë unanime kjo:

D E K L A R A T Ë

1. *Kuvendi i Komunës në Vushtrri e mbështetë vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërmarrjen e veprimeve për shtrirjen e sovranitetit në pjesën veriore të Mitrovicës.*
2. *Kuvendi i Komunës konsideron se vendimi për dërgimin e njëjësive Speciale të Policisë së Kosovës, është i drejtë, dhe plotësisht i ligjshëm, andaj kuvendi i mbështet përpjekjet për instalimin e autoritetit në atë pjesë të vendit.*
3. *Kuvendi i Komunës në Vushtrri e përkrah qëndrimin e kryeministrit të Republikës së Kosovës për vendosjen e rendit dhe ligjit në atë pjesë të vendit, si dhe inkurajon përpjekjet e Qeverisë, për të vazhduar deri në fund në vendosjen e ligjshmërisë dhe rregullit në këtë pjesë të Kosovës.*
4. *Deklarata iu dërgohet mjeteve të informimit publik.*

3. Shqyrtimi i propozimit për ndihmë financiare për familjen e heroit të Kosovës, Enver Zymerit.

Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit- propozoi që t'i ndahet shuma prej 5.000 € për familjen e heroit të Kosovës, Enver Zymerit.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- pasi që e mbështeti propozimin për shumën në fjalë, njoftoi mbi gjendjen e fondit për ndihma (subvencione), duke thënë se prej shumës mbi 150.000 €, aktualisht kanë mbetur rreth 9.000 € që mund të shfrytëzohen.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e Kuvendit- propozoi që familjes së heroit të Kosovës t'i zgjedhet çështja e banimit, pasi që jetojnë në kushte të vështira.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- e mbështeti propozimin që familjes së heroit të Kosovës t'i ndahet shuma prej 5.000 €.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Familjes së të ndjerit Enver Zymeri nga fshati Duboc, Komuna e Vushtrrisë, pjesëtar i njëjësive speciale të Policisë së Kosovës, i cili më 26.07.2011 u vra në krye të detyrës në Zubin Potok nga protestues serb, i lejohen mjete financiare në shumën prej 5.000 € (pesë mijë euro), për ndihmë momentale për shpenzime të ceremonisë së varrimit.

4. Shqyrtimi i kërkesës së NTP “Agri-Production” për vazhdim të kontratës.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- njoftoi se është zbatuar vendimi i mëhershëm i Kuvendit për dhënie në shfrytëzim të hapësirës që ekziston në atë ngastër (parcelë) dhe më 07.10.2009 është nënshkruar kontrata në mes të komunës dhe përfaqësuesit të NTP “Agri-Production”, e cila në nenin 10.1 e precizon obligimin që qiramarrësi duhet të finalizojë projektin prej 6-10 muaj nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate. Por nëse ky afat nuk respektohet nga qiramarrësi, do të konsiderohet kontrata e pavlefshme, dhe shtoi se në atë periudhë janë bërë disa mbulime të kushtueshme, por nuk është bërë finalizimi i projektit. Mandej kompania në fjalë duke pas paraysh interesin e qytetarëve të komunës së Vushtrrisë, e në veçanti për bujqtë tanë ka paraqitur një kërkesë në mënyrë që këtyre bujqve t’u mundësohet shitja e qumështit, ia i ka vazhduar kontratën kompanisë në fjalë edhe për 8 muaj, kurse brenda këtyre 8 muajve asnjë punë nuk e kanë kryer. Dhe pasi që kanë kaluar këta 8 muaj, ka dërguar një komision, i cili ka vënë re gjendjen në fabrikën e qumështit, dhe komisioni ka përfunduar(konkluduar) se punët nuk janë finalizuar, mirëpo në ndërkohë kompania në fjalë ka thënë që makinat i kanë në doganë, mirëpo si kryetar i komunës nuk kam pas të drejtë t’ia vazhdojë më tutje kontratën, prandaj kuvendi i komunës mund të merr vendim për t’ia vazhduar kontratën kompanisë në fjalë, mirëpo gjithmonë duke respektuar bazën ligjore.

Roger Nicolin, përfaqësues nga “Agri Production”- njoftoi se makinat që kanë ardhur në fabrikë janë vonuar disa muaj, dhe pasi që makinat janë në fabrikë, nevojitet një kohë e shkurtë për t’i funksionalizuar, prandaj kërkoi nga komuna që t’ua jep edhe një mundësi që këto makina t’i fusin në funksion. Në vazhdim tha se fillimi i funksionimit të fabrikës është diçka shumë serioze dhe do të ketë një perspektivë, pasi që është bërë një mbulim(investim) i madh.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit- tha se pasi që ka bërë mbulime dhe makinat qenkan në fabrikë, në emër të Grupit parlamentar të PDK-së propozoi që t’i vazhdohet kontrata edhe për 6 muaj.

Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit- tha se i mbështet investitorët e jashtëm që dëshirojnë të krijojnë vende pune në Vushtrri, mirëpo institucionet komunale duhet të respektojnë ligjet në fuqi, kontratat, kurse sa i përket rastit konkret është marrë vendim edhe në KPF që të formohet një komision nga kuvendi. Mendim i tij ishte që pasi kanë ardhur makinat, le të formohet komisioni i cili e mbështet finalizimin e projektit të filluar në afatin që ia përcakton kuvendi, dhe komisioni i tillë ta verifikojë situatën. Mandej shtoi se Komuna e Vushtrrisë po del joserioze në mbulime, pasi që është parë rasti i fshatit Stanofc, gjithashtu edhe raporti nga Agjencioni i konkurrencës, Vushtrrinë e radhit të fundit sa i përket krijimit të kushteve për zhvillimin e biznesit.

Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit- tha se i mirëpresim mbulimet, veçanërisht nga vendet e zhvilluara perëndimore, mirëpo duhet ta kuptojnë se edhe këtu po mundohemi t’i aplikojmë ligjet. Pastaj tha se është dashtë të jetë i formuar komisioni, dhe në bazë të raportit të sjellë nga ky komision, të jepet propozimi konkret brenda çfarë periudhe kohore mund të kryhen këto punë. Mandej tha se me këto prona është duke u vepruar në mënyrë të kundërligjshme, duke përmendur rastin në Stanoc, në Lumëmadh, prandaj ne nuk jemi kundër mbulimeve, por jemi për zbatimin e ligjit.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- lidhur me çështjen në fjalë, propozoi që të formohet një komision, i cili do të shkojë menjëherë në fabrikë dhe ta vlerësojë gjendjen reale, dhe ta njoftojë kuvendin. Komisioni propozohet në këtë përbërje:

Gani Imeri, Selim Rustemi, Veli Karaça, Sabri Ferati dhe Islam Krasniqi.

Aprovohet në mënyrë unanime përbërja e propozuar e komisionit në fjalë.

Vazhdimi i shqyrtimit për pikën nr.4 i rendit të ditës, pas kthimit të komisionit nga fabrika për vërtetimin e gjendjes faktike:

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- tha se komisioni në fjalë ishte në vendin e ngjarjes, dhe në emër të komisionit vërtetoi se në objekt gjendeshin katër makina (pajisje), kurse objekti ishte gati në fazën fillestare, kulmi ishte ndërruar, ishte savatuar pjesa e përparme, ndërsa brenda dhe pjesa e prapme nuk ishte e savatuar, dyer dhe dritare pjesërisht të vendosura, rryma nuk ishte vendosur deri në objekt dhe ujë nuk kishte. Ai shtoi se këto janë punë që mund të kryhen, nëse investitori është serioz dhe ka mjete.

Islam Krasniqi, anëtar i Kuvendit- kërkoi që të përkrahet investitori në fjalë, duke ia dhënë edhe një mundësi, pasi që ka bërë investime.

Sabri Ferati, anëtar i Kuvendit- propozoi që t'i vazhdohet kontrata e investitorit për 6 muaj, por investitori duhet të ofrojë garancion bankar, përndryshe ai nuk është në gjendje për ta vazhduar objektin, duke shtuar se në situatën në të cilën ndodhet objekti, kërkohen mbulime të mëdha, dhe nga kjo nënkuptohet se investitori nuk ka mjete, prandaj vetëm nëse ofron garancion bankar, propozoi që t'i zgjatet afati edhe për 10 muaj.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të PDK-së propozoi që t'i jepet një afat prej 12 muajsh.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar raportit të paraqitur nga komisioni në fjalë, tha se meqë janë bërë disa investime, pajtohem që t'i vazhdohet kontrata, por është mirë që investitori të tregojë se në çfarë periudhe kohore mund t'i finalizojë të gjitha punimet.

Abdullah Halimi, anëtar i Kuvendit- pyeti lidhur me arsyeshmërinë e vonesës, pra arsyeja e vonesës a është për shkak të ecurive, apo probleme financiare?

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- tha se e përkrah çdo investim, sidomos investitorët e huaj që janë të interesuar të investojnë në komunën tonë, por në rastin konkret duhet të tregojmë mirëkuptim, duke shtuar se pa investime të huaja, vështirë se do të kemi zhvillim ekonomik, prandaj ne duhet ta përkrahim këtë investitor, pasi që është një garë e jashtëzakonshme për të marrë investitor, dhe është një kohë që ka rënie të investimeve në të gjitha vendet.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar kërkesës së investitorit që t'i vazhdohet kontrata për 6 muaj, tha se është në interesin e fermerëve të Komunës së Vushtrrisë që qumështi të mos humbet, por qytetarët duhet ta shfrytëzojnë si mjet themelor të jetesës dhe të ushqimit. Pastaj tha se interesi i komunës është që investitorit në fjalë t'i japim rast dhe ta përkrahim, por nga ai të kërkohet që t'i kryejë obligimet ndaj Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli, anëtare e Kuvendit- pyeti se a ka bazë ligjore që t'i vazhdohet kontrata investitorit në fjalë, apo duhet nisur ndonjë ecuri(procedurë) tjetër?

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- kërkoi nga investitori që të deklarohet se për sa kohë do t'i finalizon punimet, dhe a është në gjendje të ofrojë siguri bankare, si mjet për implementimin e projektit.

Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit- tha se askush nuk është kundër investimeve, dhe jemi për të t'i lehtësuar ecuritë dhe format rreth investimeve. Duke shtuar se aty është dhënë një hapësirë që nuk ka nevojë të jetë aq e madhe, sepse edhe bizneset e tjera mund të ushtrojnë veprimtaritë e tyre në atë sipërfaqe. Pastaj tha se në rastin konkret është shkelur ligji dhe kontrata nga ana e investitorit, duke thënë se deri më tani investitori nuk ka qenë serioz në punë dhe nuk ka përmbushur obligimet e kontratës. Prandaj kërkoi që investitori të jep një siguri bankare, me qëllim që në afatin e caktuar do të përmbush obligimet e tij. Në vazhdim në emër të Grupit parlamentar të AAK-së propozoi që t'i vazhdohet kontrata për 6 muaj, me kusht që ai të sjellë siguri bankare. Gjithashtu tha se edhe forma e dhënies ka qenë jo e dukshme dhe jo ligjore, pasi që nuk ka pas konkurrencë.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se pajtohet me kërkesën e anëtarëve të kuvendit për kushtëzim ndaj kompanisë, duke shtuar se në kontratën e parë nuk ka figuruar kapaciteti i fabrikës se sa litra qumësht i përpunon brenda ditës, prandaj tash duhet të figurojë, dhe ta ketë këtë element në kontratë. Gjithashtu duhet të ketë siguri bankare, dhe kërkoi që investitori të tregojë sa kohë i nevojitet për të finalizuar punimet, pastaj kuvendi të vendos sa kohë do t'ia vazhdojë kontratën.

Roger Nicolin, përfaqësues nga "Agri Production"- tha, tani që kanë ardhur makinat, do të vendoset rryma dhe uji. Tutje tha se 75 – 80 % e punimeve janë të kryera. Ai kërkoi nga kuvendi që t'i jepet edhe një rast për të finalizuar punimet në afat prej 8 muajve. Ndërsa lidhur me kërkesën për siguri bankare, tha se nuk ka mundësi financiare për një sigurim të tillë bankar. Lidhur me kapacitetin e përpunimit të qumështit, tha se brenda 24 orëve do të përpunohen 24.000 litra qumësht, kurse në fillim të punës së fabrikës (në ditët e para) do të mund të përpunohen 10.000 litra qumësht.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- propozoi që të mos kërkohet siguri bankare, por të kërkohet siguri prej një kompanie të sigurimeve, që investitorëve iu kushton shumë më lirë.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- tha se ne duhet ta përkrahim investitorin, pasi që ne kemi nevojë për investime, dhe i njëjti investitor ka filluar punën, ka investuar, ka pasur vështirësi, dhe ne duhet ta mbështesim.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se Komuna e Vushtrrisë është e interesuar që t'i përkrah dhe t'iu krijon lehtësira investitorëve, dhe në rastin konkret kuvendi i komunës i ka dhënë një hapësirë jashtëzakonisht të mirë për të ndërtuar fabrikën, në mënyrë që t'u ndihmohet fermerëve të komunës sonë.

Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit- tha se investimi ka karakter komercial, e nuk ka karakter humanitar dhe asnjë anëtar i kuvendit nuk është i pajtimit për ta ndërprerë kontratën me investitorin, por po kërkojmë seriozitet, afate, kushte, numër të të punësuarëve dhe kapacitet në prodhim.

Hajrulla Muli, anëtar i Kuvendit- propozoi që t'i jepet edhe mundësia e dytë, pasi që ka investuar, por nëse investitori dështon përsëri, investimet i mbesin komunës.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- njoftoi se pas një konsultimi me kryetarin e komunës dhe shefat e grupeve parlamentare, u vendos që kompanisë në fjalë t'ia vazhdohet kontrata edhe për 10 muaj, pa siguri bankare, por në përmbyllje (klauzolë) të lidhje-kontratës të ceket qartë(decidivisht) se nëse investitori nuk i përmbush obligimet në afatin e paraparë me kontratë, investimet i mbesin komunës, përveç makinave.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se fakti që u pajtuam që t'ia vazhdojmë kontratën kompanisë në fjalë edhe për 10 muaj, dëshmon interesimin e komunës që të finalizojë punimet për ndërtimin e fabrikës. Pastaj tha se kushtet për kompaninë në fjalë janë: koha e kryerjes së punimeve është 10 muaj; nëse pas 10 muajve nuk finalizohen punimet, e humb çdo investim që ka bërë; kapaciteti të mos jetë më i vogël se 10.000 litra brenda 24 orëve dhe numri i të punësuarve të mos jetë më i vogël se 10 punëtorë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet kërkesa e NTP "Agri-Production" Nr. 01-7-4598, dt. 13.07.2011, për zgjatje të afatit shtesë prej 10 (dhjetë) muaj, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi për finalizim të projektit për përpunimin e qumështit, në pronën e paluajtshme të Komunës e cila i është dhënë në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim sipas vendimit të KK-së 01 Nr.617/09, dt.24.09.2009, ushtruesit të kësaj kërkesë.

Komuna e Vushtrrisë dhe NTP "Agri-Production" do të lidhin aneks-kontratë për zgjatje të afatit për finalizim të projektit, konform të cekurave në nenin 1 të këtij vendimi.

5. Shqyrtimi i raportit final i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të komunës për vitin 2010.

Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar auditimit nga auditorët e jashtëm, tha se shpenzimi i buxhetit për vitin 2010 në Komunën e Vushtrrisë ka qenë në nivel të kënaqshëm në aspektin financiar; pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me instruksionet financiare të ligjeve në fuqi, kurse si vërejtje të gjetura edhe nga auditori dhe nga vet anëtari i kuvendit janë: porositë për vitin 2009 nuk janë përfill nga organet komunale, kështu që edhe në vitin 2010 kanë qenë gabime të përsëritura. Shpenzimet e mjeteve 50 % vetëm për tremujorin e fundit për investime kapitale, tregojnë joprofesionalizëm dhe rrezikim të investimeve kapitale; komuna nuk ka mbajtur evidencë mbi llogaritë e arkëtueshme; nuk është mbajtur regjistrim i pasurive fikse të komunës dhe inventarizim në baza vjetore, me ç'rast vihet në rrezik keqpërdorimi i pasurisë së komunës. Nuk janë mbajtur regjistra të borxhlinjve (debitorëve); nuk janë regjistruar në librat e kontabilitetit borxhet e komunës ndaj operatorëve ekonomikë në fund të vitit 2010, të cilat kanë qenë në shumën 110.880 €, e të cilat është dashtë të paguhen 30 ditë pas pranimit të faturës; auditimi i brendshëm ka qenë mjaft pasiv, prandaj kërkohet nga kryetari të bëhet funksionalizimi i Komitetit për Auditim të Brendshëm; dorëzimi i pasqyrave financiare të komunës për vitin 2010 që nuk është bërë me kohë në organin e thesarit. Gjatë shfletimit të aktvendimeve mbi ngarkesat në taksë komunale, nuk është përfill Rregullorja mbi tarifrat dhe ngarkesat; ka pas biznese që janë pajis me certifikata kinse nuk kanë pasur obligime, kurse në gjetje është vërtetuar e kundërta; nuk ka regjistrim të llogarive të arkëtueshme mbi të hyrat nga lejet e ndërtimit. Gjithashtu te prokurimi ka vonesa në ekzekutimin e punëve, dhe nuk janë aplikuar penalet; ka operator ekonomik që ka fituar tenderin për furnizim me derivate, pa e pasur licencën nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Bëhen pagesa të punëtorëve duke e anashkuar koeficientin mbi pagën; pagesa e pagave retroaktive për punëtorët pa kontratë; shfrytëzimi i mjeteve për udhëtime zyrtare dhe organizime të ndryshme pa i përfillur procedurat e prokurimit. Bartja e mjeteve nga llogaria e komunës në emër të personit fizik dhe pagesa e mjeteve për "Takimin e Poeteshave" nga llogaria e personit fizik, si dhe mungesa e Rregullores për dhënien e subvencioneve, që tash e kemi. Pastaj tha se për të gjitha të gjeturat nga Auditori i Jashtëm, kryetari i komunës së bashku me stafin menaxhues duhet të kujdeset që të njëjtat të mos përsëritën, dhe njëkohësisht të shtojë përgjegjësinë mbi stafin e tij për të qenë shumë profesional, sidomos në procedurat financiare.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- tha se duhet pasur parasysh vërejtjet e auditorit, duke shtuar se duhet të mënjanohej parregullsitë e evidentuara. Pastaj tha se Auditori i Brendshëm duhet të jetë i sforcuar, dhe të jep vërejtje pa rezerva ndaj drejtorive të veçanta, sepse nëse Auditori i Brendshëm e korrigjon punën e drejtorive, nuk do të ketë nevojë Auditori i Jashtëm të paraqesë tërë këto vërejtje. Në fund kërkoi që vërejtjet e Auditorit të Jashtëm të inkuorohen, duke mos u përsëritur për çdo vit vërejtjet e njëjta.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- lidhur me çështjen e disa koeficientëve në Drejtorinë e Arsimit, paraqiti skepticizmin e tij se auditori e ka kryer mirë detyrën, pasi që kur auditori gjen lëshime të tilla, është i obliguar të kërkojë më shumë mostra. Ai pohoi se probleme të tilla të shërbyesit civil ka shumë, ka punëtorë që kanë punuar pa kontrata, ka ndërime të koeficientëve, dhe nëse duhet të bëhet kompensimi për një person, atëherë duhet të bëhet për të gjithë. Pastaj duke bërë një paralele në mes të auditimit të vitit të kaluar dhe auditimit të këtij viti, vërehet një diferencë jashtëzakonisht e madhe për nga kualiteti. Sepse sipas raportit që ka ardhur tani nga Auditori Gjeneral, mund të thuhet se komuna ka bërë një përparim të jashtëzakonshëm, mirëpo realiteti është se kualiteti i auditimit është shumë i dobët,

sepse të gjeturat janë shumë sipërfaqësore, dhe te konkluzioni kryesor është bërë gabim në material, meqë ka dhënë mendim pa asnjë kualifikim, vetëm me shkoqitje të rasteve. Kjo flet për një shkoqitje të jashtëzakonshme të menaxhimit të buxhetit komunal, dhe nëse shikohen vetëm provat e gjetura dhe kualifikimet e auditorit, janë në disproporcion njëra me tjetrën, prandaj tha se auditori ose ka qenë i ndikuar në këtë konstatim, ose i mungojnë shkathtësitë profesionale. Në vazhdim tha se auditimi i vitit të kaluar ka qenë për rrënqethje, dhe në bazë të atij auditimi, është dashtë që dikush të përballet me drejtësinë, kryetari ose dikush nga ata që i ka emëruar kryetari. Ai tha se kryetari i komunës nuk ka marrë masa brenda vitit, nuk ka bërë asnjë plan të implementimit të rekomandimeve, prandaj kryetari i komunës, drejtori i buxhetit dhe financave, së bashku me KPF-në është dashtë të marrin në përgjegjësi, por kjo nuk ka ndodh.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit- e përgëzoi kryetarin e komunës, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë stafin e komunës për një vit të suksesshëm. Pastaj tha se auditori ka dhënë një konkluzion se menaxhmenti i komunës ka qenë mjaft efektiv në planifikim dhe shpenzim të buxhetit, kurse shkalla e realizimit buxhetor ka qenë 95%, dhe kjo nënkupton një performancë shumë të mirë menaxheriale. Kurse lidhur me harmonizimin e koeficientëve të pagave, drejtorja në fjalë e ka zbatuar rekomandimin e auditorit, dhe ka filluar t'ua ndalojë mjetet që i kanë përfutur gjatë asaj kohe. Gjithashtu, auditori ka rekomanduar që të hartohet një Rregullore për ndarjen e subvencioneve, dhe e njëjta rregullore është aprovuar më 24.02.2011 nga kuvendi i komunës, e cila përcakton kushtet dhe ecuritë e përfitimit të subvencioneve. Mandej tha se të gjitha drejtoritë komunale kanë përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori Gjeneral.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se është ndër raportet më të mira që janë bërë deri më tani në auditivet. Duke shtuar se në bazë të rekomandimeve të bëra nga Auditori Gjeneral, kemi bërë planin e implementimit, mirëpo pasi që auditimi po bëhet në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik edhe Komuna e Vushtrrisë po hasë në vështirësi në implementimin e pasqyrave financiare, pasi që për vitin 2011 buxheti është miratuar nga niveli qendror në muajin prill. Ai njoftoi se mbi 50% e buxhetit do të mund të shfrytëzohet në 6-mujorin e dytë, për shkak të procedurave të tenderimit dhe të realizimit të buxhetit. Në vazhdim shtoi se pasqyrat janë dërguar me kohë, edhe pse tri herë janë bërë ndryshime, për arsye se prerja e sistemit të free-balancit, pra barazimet janë bërë në fund të muajit mars, kurse pasqyrat janë dorëzuar në fund të muajit janar.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se auditimet janë të domosdoshme dhe janë shumë të rëndësishme për secilin pushtet dhe institucion në nivelin lokal dhe qendror. Pastaj tha se opinioni i Auditorit Gjeneral është se pasqyrat kryesore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë, dhe është dhënë opinion i pakualifikuar. Pastaj tha se 10 rekomandimet e dhëna nga Auditori Gjeneral i ka marrë shumë seriozisht duke analizuar secilin rekomandim së bashku me drejtorët e drejtorive, dhe ka urdhëruar që të bëhet plani i veprimit nga secila drejtori që është prekur me rekomandime. Mandej tha se ka qenë brengosëse që nuk janë realizuar të gjitha rekomandimet e vitit të kaluar, por ka qenë e pamundur që të realizohen disa rekomandime. Në vazhdim duke iu referuar çështjes së koeficientëve, tha se ndërrimet e koeficientëve janë bërë me vendim të kryetarit të komunës, dhe janë bërë në rastet ku zyrtarët e komunës e kanë të përfunduar fakultetin, duke shtuar se deri në fund të vitit secilit punëtor do t'i rregullohet çështja e pagës në harmoni me Ligjin e Punës. Pastaj tha se puna e Auditorit të Brendshëm është për ta ndihmuar kryetarin e komunës gjatë tërë vitit.

6. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatim në pronën e paluajtshme për vitin 2012 (shqyrtimi i parë).

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- tha se draft-rregullorja në fjalë, me përjashtim të pjesës hyrëse që është bazuar në ligjin më të ri për tatimin në pronë, është e tëra kopje e rregullores e vitit të kaluar. Pastaj paraqiti këto vërejtje: në nenin 3 fjalia “tërë pronën e paluajtshme në komunë”, ky nen vjen në kundërshtim me nenin 6 të kësaj rregulloreje, pasi që kur të numërohen pronat e paluajtshme, numërohen vetëm objektet. Te neni 5, duke iu referuar paragrafit të dytë, tha se është për t’u befasuar se si ka mundur të jetë vlera e tregut për këto objekte të njëjta 100 % si në vitin 31 dhjetor 2009, dhe më 31 dhjetor 2010. Te neni 6, te norma e tatimit propozoi për: “pronë rezidenciale (banesë-apartament)” të zbritet nga 0.12 në 0.10, sepse nëse mbetet e njëjta normë e tatimit si për pronë rezidenciale (banesë-apartament), dhe pronë rezidenciale-shtëpi, atëherë qytetari do të orientohet më shumë në ndërtim të shtëpisë, se sa në objekte të larta. Pastaj tek “prona komerciale (pishinat, fushat sportive)”, tha se vitin e kaluar ka qenë e tatimuar me 0.13 %, kurse tani është ngritur me 0.19 %. Mirëpo është anomali e hartuesit që e ka bërë te “prona e pa meremetuar dhe jo e gatshme komerciale”, pasi që edhe kjo ka qenë 0.13 %, kurse tani është 0.19 %, e që është barazuar me pronën komerciale, e cila është në funksion dhe shfrytëzohet. Prandaj është dashtë të merret parasysh që nuk mund të jetë norma e njëjtë si për pronë komerciale, dhe pronë të pa meremetuar dhe jo të gatshme komerciale, meqë nuk përfitohet asgjë nga kjo e fundit. Te neni 7, propozoi që të merren në shqyrtim 8 udhëzimet administrative që para një muaji janë nënshkruar nga ministri, dhe të mos thirret në udhëzimet administrative që nuk janë në fuqi. Te neni 8, lidhur me zonën e IV-të, tha se me miratimin e planit zhvillimor komunal urban në vitin 2009, planet urbanistike të fshatrave që kanë qenë të urbanizuara sipas bashkimit të copave (komasacionit), nuk janë më të zbatueshme, dhe tani ka mbetur që sipas dëshirës të ngarkohen qytetarët kush është në atë zonë urbanistike, ose jo. Te neni 10, duhet të hiqet Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2003, dhe të thirret në udhëzimin adekuat. Në fund tha se Grupi parlamentar i LDK-së me këto propozime të paraqitura, e përkrah që të shkojë në diskutim publik.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft-rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për territorin e Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2012.

Diskutimi publik fillon nga data 29.07.2011 dhe zgjatë deri më 29.08.2011.

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me të hyrat komunale janar-qershor 2011.

Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit- sa i përket realizimit të të hyrave në 6-mujorin e parë të vitit 2011, tha se është një realizim i kënaqshëm, krahasuar me 6-mujorin e njëjtë të vitit 2010, por ka një rënie në krahasim me planifikimin, prandaj këto të hyra mund të rriten edhe më tutje. Kurse sa i përket sektorit të financave publike dhe sektorit të tatimit në pronë, ka rritje të kënaqshme të të hyrave, por i propozoi drejtorisë në fjalë që në informatën mbi realizimin e të hyrave, të paraqesë edhe sektortë tjerë ku ka ngecje, me qëllimin që të merren masa për të paraqitur propozime se si të mbledhen sa më shumë të hyra.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se shihet që në disa kategori ka pas të hyra më shumë, prej asaj që është planifikuar. Pastaj tha se fakti që Auditori Gjeneral i ka rekomanduar kryetarit të komunës që të përmirësojë planifikimin, nënkupton se jo gjithëherë planifikimi është i bazuar në parametra real. Mandej tha se të hyrat që janë planifikuar për këtë periudhë kohore janë tejkaluar, mirëpo nëse i referohemi raportit të zyrës së Auditorit Gjeneral, shihet se planifikimi i të hyrave nuk ka qenë i bazuar plotësisht në parametra real.

Fakti që Komuna e Vushtrisë ende çalon, dhe se ka telashe në regjistrat e pasurive të veta, nënkuptohet se nga ky mosregjistrim i pasurive të komunës mund të ketë edhe mosinkasim të të hyrave komunale, sepse nëse një pronë e caktuar komunale nuk është e evidentuar, ajo mund të shfrytëzohet duke mos përmbushur asnjë obligim ndaj komunës, dhe kjo reflekton edhe në të hyrat komunale. Duke iu referuar faqes nr. 8 të informatës në fjalë, kategorisë “licencat për lojëra zbavitëse, pije alkoolike dhe reklamime” pohoi se shuma e planifikuar ka qenë 25.000 €, kurse në tabelë figuron që asnjë cent nuk është arkëtuar, prandaj parashtroi pyetjen se mbi ç’bazë është bërë ky planifikim? Pastaj kategoria tjetër “reklamimi dhe publikimi në pronën komunale”, tha se ka reklamime në pronën komunale dhe përkundër planifikimit prej 25.000 €, nuk ka të arkëtuar asnjë të hyrë, prandaj kërkoi nga drejtori për buxhet dhe financa që të jep sqarime se si u bë që në këto dy kategori janë planifikuar nga 25.000 € në të dyja rastet, kurse nuk është arkëtuar asnjë cent nga to. Gjithashtu për kategorinë “shfrytëzimi i tokës dhe lejet ndërtimore”, tha se ka qenë 115.583 € shuma e planifikuar e të hyrave, kurse janë inkasuar 137.541 €, duke pyetur se si është arritur kjo? Nëse i referohemi shfrytëzimit të tokës që e jep komuna, ndërrimit dhe caktimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nuk duhet të mburret komuna se ka pas të hyra shumë, pasi që janë dhënë leje ndërtimi për t’u zënë toka pjellore, prandaj e gjithë kjo është e papranueshme. Te kategoria “shfrytëzimi i pronës komunale (kiosqet)”, tha se akoma nuk kemi informacione se cila është prona e vërtetë komunale, prandaj kërkoi nga kryetari i komunës që të identifikohet prona komunale, dhe në këtë mënyrë të kuptohet se kush po e shfrytëzon dhe kush po përfiton, pasi që ka të tillë që e shfrytëzojnë pronën komunale, dhe nuk kryejnë asnjë obligim. Në vazhdim lidhur me kategorinë “gjobat në trafik”, tha se shuma e planifikuar është 65.500 €, kur janë inkasuar 15.351 €, dhe pyeti mbi ç’bazë është bërë ky planifikim? Ndërsa për kategorinë “të hyrat nga donacionet”, tha se kishte me qenë mirë që kryetari i komunës së bashku me drejtorinë të analizojë, pasi që në këtë periudhë kohore kanë qenë të planifikuara 116.891 €, kurse janë arkëtuar vetëm 46.388 €, kështu që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, është gati përgjysmë më e vogël. Në fund, te kategoria “të ardhurat nga arsimit mesëm”, tha se të hyrat janë 9.258 €, kurse nuk ka fare planifikim paraprak, dhe pyeti se si ka ndodhur që të mos ketë fare planifikim, kur dihet se ka të hyra nga arsimit mesëm.

Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar sektorit të tatimit në pronë, tha se mungon një informatë e saktë dhe se gjatë vitit a po kryhet një obligim i verifikimit të sipërfaqeve të pronave, pasi që është obligim ligjor dhe se a ka përputhje me sipërfaqet e paraqitura si prona reale?. Ai shtoi se më herët në raste të tilla gjatë verifikimeve ka pas lëshime dhe gabime në matjen e sipërfaqeve të shtëpive dhe pronave të ndryshme, e posaçërisht ka qenë kjo dukuri tek disa biznese, në të cilat janë zvogëluar sipërfaqet, prandaj është obligim i kryetarit që brenda kohës të formojë komisionet dhe të bëhet verifikimi ad hoc i sipërfaqeve të pronave dhe të bëhet kontrollimi se a ekziston përputhje reale. Mandej tha se nuk kemi informacione se sa ka rritje të numrit (faturave, vendimeve) për këtë vit, krahasuar me vitin paraprak, dhe shtoi se ka mbetur një numër i madh i faturave të padorëzuara, pra kanë mbetur 2432 vendime të padorëzuara. Mandej lidhur me komentin se “edhe këtë vit komuniteti pakicë nuk ka pranuar faturat e tatimit në pronë”, tha se është fjalë e përgjithësuar, sepse komuniteti turk dhe ashkali kanë përmbushur edhe më herët obligimet. Në vazhdim tha se është dashtë të përgatitet raport se sa është rritur numri i tatimpaguesve në tatimin në pronë. Në fund, lidhur me planifikimin, tha se duhet të dihet numri i obliguesve, të dihet sa kemi borxhe nga vitet paraprake të mbetura, prandaj kërkoi që kuvendi në mbledhjen e ardhshme në mënyrë konkrete të debatojë çështjen e gjendjes së obligimeve.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit- kërkoi sqarim nga Drejtoria për Shëndetësi pse ka rënie prej 14 % në vjeljen apo participimin në shëndetësi (në shëndetin primar në

nivel të komunës) për vitin 2011, që krahasuar me vitin 2010, diferenca është shumë e madhe.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- tha se në planin e punës së kuvendit thuhet që Drejtoria për Financa duhet ta informojë kuvendin lidhur me arkëtimin e të hyrave, e cila do të jetë informatë tre mujore, pra në bazë të planit të punës drejtoria në fjalë ka përgatitur informatën në vija të trasha, duke shtuar që nuk ka forma standarde të raportimit, dhe secila komunë raporton në formën e vet. Kurse lidhur me vërejtjet e paraqitura tek çështja e planifikimit, tha se planifikimi është miratuar në kuvend, por tabelari është i komplikuar, dhe është formë standarde që dorëzojmë çdo muaj edhe në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Në vazhdim sqaroi në detaje përmbajtjet e kategorive në tabelar. Gjithashtu njoftoi se në këtë realizim të të hyrave bëjnë pjesë edhe të hyrat e paarkëtueshme nga vitet e kaluara. Mandej për të hyrat nga arsimit mesëm, tha se është fakt që shkollat profesionale në vitin 2010, kanë paraqitur provimet dhe ne nuk kemi pasur një planifikim se çfarë të hyra do të ketë, por në të ardhmen do ta kemi parasysh, dhe do ta fusim edhe këtë. Në fund, lidhur me vërejtjen për të hyrat e paarkëtueshme, tha se këto të hyra do të deklarohen në pasqyrat financiare, kurse kjo është informatë, e jo raport.

8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë, i procesit mësimor për vitin shkollor 2010/2011.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se është brengosëse gjendje e suksesit nëpër disa shkolla të Komunës së Vushtrrisë, duke përmendur rezultatet e dobëta në shkollën e mesme teknike “Lutfi Musiqi”, gjithashtu përmendi rezultatin e dobët në shkollën e mesme profesionale “Bahri Haxha” dhe në gjimnazin “Eqrem Çabej”, duke shtuar se gjendja më e mirë është në gjimnaz, por gjendje e rëndë është në shkollën e mesme teknike dhe në shkollën e mesme profesionale, prandaj këtë gjendje nuk duhet ta lejojmë në pafundësi, dhe duhet të organizojmë një tribunë, në të cilën do të marrin pjesë ekspertë të fushës së arsimit, këshillat e prindërve, të nxënësve, në mënyrë që të dalim nga kjo situatë e keqe, duke thënë se nëse vazhdohet me rezultate të tilla të dobëta, nuk ka kuptim ekzistimi i dy shkollave teknike, me rezultatin 3.73 %, prandaj kërkoi nga kuvendi i komunës, kryetari i komunës dhe Drejtoria e Arsimit që ta hartojnë një strategji për të dalë nga kjo gjendje në të cilën ndodhemi.

Habib Mustafa, anëtar i Kuvendit- tha se është një ndër informatat më të mira që na ka ardhur nga Drejtoria e Arsimit, dhe në këtë informatë janë paraqitur të gjitha nivelet e organizimit të mësimin në Komunën e Vushtrrisë, projektet e realizuara dhe aktivitetet e ndryshme të drejtorisë në fjalë, suksesin e nxënësve në shkolla, si dhe vështirësitë gjatë këtij viti shkollor. Pastaj tha është brengosës suksesi i nxënësve, prandaj është mirë që të bëhet një analizë, duke filluar nga drejtoria e shkollave, Drejtoria e Arsimit, dhe së bashku me ekspertë tjerë të hulumtohen shkaqet e suksesit të dobët, duke shtuar se nuk ka dyshim që kushtet teknike nëpër shkolla janë shumë më të mira se më herët, edhe niveli i profesorëve është i kënaqshëm, mirëpo duhet ndryshuar qasja.

Hajrulla Muli, anëtar i Kuvendit- lidhur me rezultatet e dobëta, tha se në shkollën e mesme profesionale “Bahri Haxha” një ndër shkaqet e rezultateve të tilla ka qenë mungesa e teksteve, ku 80 % e lëndëve nuk kanë tekste. Në vazhdim tha se shkolla në fjalë ka laborator të cilësisë së lartë, që më herët nuk i ka pasur, dhe në këtë vit kanë punuar mbi 100 nxënës nëpër ferma në mënyrë që të specializohen.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar informatës, tha se duhet kërkuar një qasje për ndryshim të gjendjes, dhe të dhënat e paraqitura në informatën në fjalë janë shumë brengosëse, krahasuar me investimet që janë bërë në infrastrukturë, në trajnimin dhe përgatitjen e stafit shkollor. Gjithashtu tha se edhe në këto të dhëna statistikore nuk ka vlerësim real, përveç testit të arritshmërisë, duke thënë se një

vlerësim është real kur bëhet nga një organ i tretë, dhe pyeti se si është e mundur që të gjithë nxënësit që jenë regjistruar në gjimnaz, në vitin e parë, në mesin e tyre të ketë 10 – 15 % të dobët, 20 % mjaftueshëm, dhe nga kjo nënkuptohet se nuk ka vlerësim real. Pastaj tha se nuk guxojmë të krahasohemi me gjendjen nëpër komunat tjera, por duhet të krahasohemi me mundësitë, nevojat dhe kërkesat që koha i ka për një rini të arsimuar. Mandej janë shqetësuese rezultatet nga testi i arritshmërisë, megjithëse nuk janë shfrytëzuar as mundësitë minimale që ky rezultat të jetë më i madh, dhe faktor kryesor është moslogaridhënia dhe papërgjegjësia. Prandaj këto të dhëna statistikore të paraqitura në këtë informatë, janë një mundësi e mirë për të bërë një analizë profesionale, nga njerëzit kompetent, duke analizuar se cilat kanë qenë gjërat e mira, cilat kanë qenë dobësitë që janë reflektuar, dhe nuk do të ketë sukses pa disiplinë. Prandaj pa i identifikuar dobësitë, nuk mund të hartohet strategji për ta ndryshuar gjendjen, gjithashtu duhet vlerësuar kërcënimet se a po arsimojmë analfabetë, a po shpenzojmë miliona buxhet të taksapaguesve për të pasur sukses të dobët të kalueshmërisë. Në vazhdim tha se deri në fund të vitit, Drejtoria e Arsimit duhet të del me një strategji për përmirësimin e gjendjes, dhe duhet të jetë obligative për të gjithë, sepse nuk mund të ketë askush vend të siguruar të punës për të prodhuar analfabeta. Në fund tha se janë tri komponente të cilat duhet ndikuar te nxënësi, te prindi dhe te shkolla.

Vlora Qirezi, anëtare e Kuvendit- tha se kishte me qenë mirë që në informatën në fjalë të paraqitet edhe numri i personelit arsimor. Pastaj tha se është dhënë suksesi i nxënësve për të gjitha nivelet e arsimit në komunën tonë, mirëpo nuk është dhënë një vlerësim i përgjithshëm, prandaj kërkoi që informata e radhës t'i ketë këto të dhëna. Gjithashtu nuk ka të dhëna në informatë se në shkollat tona a ka, apo nuk ka aktivitete të lira, siç janë: orët letrare, shfaqjet teatrale, garat në disiplinat e ndryshme sportive etj. Kurse lidhur me rezultatet e dobëta të nxënësve në testin e maturës shtetërore, dhe pasi që analiza e testit shërben si instrument që në të ardhmen të ngritet cilësia e suksesit nëpër shkolla, Grupi parlamentar i LDK-së propozon që Drejtoria e Arsimit të bëjë një analizë të rezultatit të testit që të dihet në mënyrë të qartë puna e secilit mësimdhënës, meqë suksesi i testit varet edhe nga puna e mësimdhënësve. Gjithashtu, kërkoi që mbajtja e testit të maturës në afatin e gushtit të mbahet nëpër shkolla, për arsye se sallat sportive nuk i plotësojnë kushtet për mbajtje të testit të maturës.

Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se te realizimi i projekteve dhe te mirëmbajtja ka pak të dhëna, pasi që është dashtë të informohemi më gjerësisht. Kurse te shtylla “aktivitete tjera të DKA-së”, tha se do të duhej të ishin paraqitur të ndara aktivitetet e lira, kurse nuk mund të jetë aktivitet tjetër provimi i maturës shtetërore, apo testimi i klasëve të V-ta, testimi i arritshmërisë së klasëve të IX-ta, prandaj është e drejtë të shoqërohen me komente se a janë reale këto rezultate dhe a përputhen me rezultatet që janë tek suksesi, dhe shtoi se nuk është real pasi që nuk përputhet me suksesin e tri shkollave të mesme. Mandej lidhur me transportimin e nxënësve, tha se mungon informata se a transportohen nxënësit e retarduar (me aftësi të kufizuara). Gjithashtu, një ndër problemet është puna praktike nëpër shkollat profesionale dhe teknike, duke shtuar se as në informatën në fjalë nuk ka ndonjë shpjegim si është bërë dhe a është mbajtur praktika, dhe cili është suksesi. Prandaj kërkoi që në informatat e radhës të informohemi lidhur me këtë çështje dhe tha se nuk ka informacione se a është ndërmarre ndonjë masë ndaj punëtorëve të arsimit. Ai ceku edhe çështjen e mosemërimit të disa shkollave që janë pavarësuar, gjithashtu çështja e mosemërtimit të drejtorëve në disa shkolla, të cilat funksionojnë akoma me ushtrues detyre. Si një ndër vështirësitë është mirë të hyjë në informatë edhe administrimi i shkollave tona në gjuhën serbe. Në fund tha se në raport të Drejtorisë së Arsimit duhet të paraqiten të gjitha masat që ndërmerren te mirëvajtja, te infrastruktura, të cilat ndikojnë në

sukses, edhe pse përkundër investimeve të bëra në arsim, sukcesi i nxënësve është duke shënuar rënie.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- kjo informatë është një pasqyrë e mirë për ta kuptuar se si është gjendja në arsim, ku janë dobësitë dhe çfarë duhet të ndërmerret që kjo gjendje të ndryshojë pozitivisht. Pastaj duke iu referuar nivelit të tretë, klasët X-XIII, thuhet në gjysmëvjetorin e parë në shkollën e mesme teknike, sukcesi ka qenë 26 %, kurse në gjysmëvjetorin e dytë 67 %, kurse në testin e maturës kalojnë vetëm 3.73 %, dhe nga kjo nënkuptohet se është një përmirësim joreal i suksesit, prandaj Drejtoria e Arsimit duhet të ndërmerren masa, pasi që nuk është një gjendje e lakmueshme. Në vazhdim tha se duhet të ndërmerren masa nëse një shkollë ka rezultate të dobëta, ka me mijëra mungesa, ka dëmtim të inventarit, ka numër të madh të notave të dobëta, dhe kërkoi që të aplikohet llogaridhënia.

Bahrije Pllana, anëtare e Kuvendit- tha se testi kombëtar dhe testi i arritshmërisë kanë treguar rezultate jo të kënaqshme, andaj propozoi që Drejtoria e Arsimit, Komiteti Konsultativ për Arsim të bëjnë një analizë strikte pse rezultati është në kontrast me suksesin, dhe në atë analizë të hyjë përpilimi i testeve, kontrollimi real i testeve, kushtet në të cilat mbahet testi. Pastaj tha se përveç shkollave të mesme, situata është alarmante edhe në shkollat fillore. Në vazhdim njoftoi se Grupi joformal i grave anëtare të Kuvendit është në përpilim e sipër të një projekti për të punuar me nxënësit që kanë ngecje në shkrim lexim, dhe kërkoi nga Drejtoria e Arsimit numrin e nxënësve të cilët kanë ngecje të tilla, projekt ky i cili do të mbështetet nga USAID-i, por do të kërkohet mbështetje edhe nga komuna.

Islam Krasniqi, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se duhet gjetur udhërrëfyesi se si të ecet përpara, si të dalim prej krizës, edhe pse kushtet në shkolla janë të mira, mësimdhënësit janë të përgatitur, dhe propozoi që në të ardhmen mësimdhënësit të kenë më shumë kontakt me prindërit, pasi që prindërit janë një shtyllë e madhe që mund të ndikojnë te fëmijët e tyre.

Selvete Sholla, anëtare e Kuvendit- tha se është gabim shumë i madh që testi i maturës për gjimnaz, i njëjti vlen edhe për teknikë, të ketë pyetje nga lëndë të cillat për katër vite nuk i kanë mësuar në teknikë. Gjithashtu në test ka pyetje për lëndët që në gjimnaz janë tri orë mësimi për të, kurse në teknikë dy orë mësimi, dhe nuk përputhen planprogramet e gjimnazit me teknikën, prandaj kërkoi nga drejtori i arsimit që për herat tjera të kërkojë në Ministri të Arsimit që të bëhet dallimi i testit mes shkollës profesionale, teknike me atë të gjimnazit, për arsye se ndryshojnë planprogramet dhe struktura e nxënësve.

Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim- tha se kjo është informata më e mirë e përgatitur deri më tani, pasi që në të janë inkuorporuar vërejtjet dhe sugjerimet e anëtarëve të Kuvendit. Pastaj tha se testi i arritshmërisë për klasë të IX-ta është mbajtur në nivelin kërkuar, një nxënës-një bankë. Kurse lidhur me testin e klasëve të V-ta, tha se Ministria e Arsimit ka mbajtur një test për klasët e V-ta, të organizuar vetëm në katër shkolla, testi i njëjtë, vetëm monitorues të ndryshëm, por rezultatet janë për 20 % më të dobëta, dhe nga kjo nënkuptohet se vlerësimi i testit varet shumë nga monitoruesit. Kurse testi për klasët e IX-ta është mbajtur nën organizimin e Drejtorisë së Arsimit, dhe mënyra e organizimit është vlerësuar pozitivisht nga ministria, por rezultati i testit ka dalë i dobët, dhe si drejtor i arsimit është dashtë të marrë vendim për të anuluar një kriter të konkursit për t'u pranuar nxënësit në gjimnaz, pasi që nuk kanë mundur t'i plotësojnë 10 pikë nga testit të arritshmërisë për lëndët prioritare. Mandej njoftoi se transporti i nxënësve me nevoja të veçanta për dy klasët e shkollës "Ali Kelmendi" bëhet nga ministria. Kurse, sa i përket punës praktike në shkollat profesionale, tha se ka përmirësim të dukshëm, sidomos në shkollën profesionale "Bahri Haxha", falë investimeve të DANIDA-s. Në shkollën teknike nuk ka nivel të kënaqshëm, dhe shtoi se ka menduar që drejtimet e ekselencës të mos ekzistojnë më në Vushtrri, por është menduar që nxënësit që kanë interesim për këto drejtime, t'u ndihmohet në formë të bursave dhe të shkojnë në

ato komunat të cilat kanë drejtime të tilla. Në vazhdim njoftoi se janë dy raste që janë suspenduar një mësimdhënës, dhe rasti tjetër është suspenduar nga çerdhja një punëtorë, gjithashtu janë edhe 5 raste që janë shqiptuar masa disiplinore në gjimnaz, pasi që mësimdhënësit me klasët e X-ta kanë organizuar ekskursion. Ai tha se emërimi i shkollave është në procedurë e sipër, ndërsa lidhur me emërimin e drejtorëve tha se është rasti i shkollës “Anton Zako Çajupi” dhe shkollës “Bajram Curri” ku ka ushtrues detyre të drejtorit, por është hapur konkursi dhe kjo gjendje së shpejti do të përfundojë. Ndërsa, sa i përket procesit mësimor në shkollat ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe, tha se Drejtoria e Arsimit nuk ka qasje, dhe punëtorët serb nuk marrin paga nga Drejtoria e Arsimit, duke pohuar se interesimi i drejtorisë është për bashkëpunim, por interesimi i ndërsjellë nga ana e tyre po mungon. Në vazhdim njoftoi se testet përpilohen në Ministrinë e Arsimit nga komisionet përkatëse, mirëpo disa shqetësime që janë ngritur nga anëtarët e kuvendit do t'i përcjellë në komisionin për testin e maturës shtetërore, për të shikuar mundësitë e ndryshimit apo përshtatshmërisë, dhe shtoi se përmbajtja e testeve për gjimnazin nuk është e njëjtë edhe për shkollat teknike. Në fund, njoftoi se janë duke u bërë përgatitjet që të fillojë arsimit parashkollor në shkollat fillore, në të cilat plotësohen kushtet, dhe kjo do të ndikojë në përgatitjen e nxënësit për fillimin e arsmimit.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se është obligim i tij si kryetar i komunës që të plotësojë kushte themelore për mbajtjen e mësimit dhe të ngritjes së cilësisë në mësimin, me pohimin se është krijuar hapësirë e gjërë shkollore, dhe asnjë shkollë nuk punon me tri ndërrime. Pastaj tha se të ardhurat e punëtorëve të arsimit janë shumë më të mira se në të kaluarën dhe se në shumicën e shkollave është vendosur ngrohja qendrore. Mirëpo kryetari nuk ishte i kënaqur me mënyrën se si është organizuar testi i fundit në Komunën e Vushtrrisë, i mbajtur në Sallën Sportive, me të gjithë nxënësit përnjëherë, dhe shtoi se testi do të ishte më i suksesshëm sikur të organizohej në grupe më të vogla të nxënësve, prandaj i sugjeroi drejtorit të arsimit që herave tjera të mos ndodh diçka e ngjashme në organizimin e testit kombëtar.

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartje të mjeteve nga mbetjet e projekteve kapitale të tenderuara të DSHMS-së.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së z.Pllana tha se ne jemi të kënaqur që QMKF-ja po realizohet si projekt, kurse projekti i furnizimit të rëntgenit, i cili kushton rreth 80.000 € ka nxjerrë disa dilema, sepse niveli primar dhe sekondar në qytetin e Vushtrrisë deri më tani ka qenë bashkë, dhe nuk ka potencial kadrovik që ky rëntgen të mbulohet nga ekspertë të duhur dhe të kryejë punë funksionale. Si dhe nuk kemi aq shumë mjete për të mos menduar për të bërë një furnizim më të mirë, prandaj kemi një propozim që drejtori i spitalit, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe drejtorin e QKMF-së ta analizojnë dhe të vinë në një përfundim që këto mjete të shfrytëzohen më arsyeshëm(racionalist), dhe shtoi se QKMF-ja në këto rrethana nuk mund ta kryejë punën e vet, edhe spitali mbetet keq, kurse Vushtrria ka tre radiologë, një është në funksion, e dy të tjerët jo, prandaj mos të ndodh që aparati i cili blehet të mos shfrytëzohet dhe amortizohet.

Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së e mbështeti bartjen e mjeteve në fjalë, dhe bëri thirrje që nëse ka mjete të tepruara nga projektet e realizuara, ato mjete të derdhen në rregullimin e disa rrugicave që kanë mbetur që një kohë të gjatë pa u rregulluar, në mënyrë që mjetet tepricë në fund të vitit të mos barten për vitin e ardhshëm.

Safet Idrizi, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi- njoftoi se vitin e kaluar është bërë furnizimi për qendrën (objektin) e re me pajisje dhe inventar, por edhe këtë vit kemi

bërë disa furnizime të ngjashme. Pastaj tha se në planifikim kanë qenë 45.000 € për aparat të rëntgenit, duke ia shtuar edhe mbetjet nga ambulanta në Pasomë dhe Vushtrri. Ai tha se rëntgeni është i domosdoshëm, pasi që sipas strategjisë së zhvillimit të shëndetësisë çdo QMF duhet të funksionojë 24 orë, dhe nuk guxojmë të mbesim pa aparat të rëntgenit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota “për”, 6 “kundër”, të tjerët “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim, mjetet buxhetore të tepruara të DSHMS-së nga programet buxhetore të mjeteve të lira, si vijon:

1) Mjete të planifikuara për projektin „Furnizim me inventar dhe paisje për QKMF-në e re” me kod ekonomik (83140). Vlera e planifikuar për këtë projekt ka qenë 74.606.00 €, vlera e kontraktimit të këtij projekti pas tenderimit ka qenë 41.499.00 €. Teprica e mjeteve në vlerë prej 33.107.00 € të ridestinohet nga ky projekt në projektin me kodin ekonomik (83141) „Rëntgeni “ (Për QKMF-në e re).

2) Mjetet e tepruara të lira nga projekti „Instalimi i rrjetit të ujësjellësit me infrastrukturë përcjellëse në Pasomë (Sumë)” me kod ekonomik (83142). Vlera e planifikuar për këtë projekt ka qenë: 10.000.00 €. Ndërsa teprica e mjeteve prej 1.842.00€ të bartet në projektin me kod ekonomik (83141) „Rëntgeni”.

10. Shqyrtimi i raportit të komisionit lidhur me petitionin e banorëve të fshatit Begaj, nr. 534/11, dt. 09.06.2011, në lidhje me kundërmimin e varrezave të qytetit në fshatin në fjalë.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar konstatimeve të komisionit në fjalë, tha se raporti i komisionit është kundërthënës(kontradiktor), pasi që komisioni në fund rekomandon të formohet një komision i ekspertëve për ta vlerësuar çështjen, duke vazhduar se komisioni në fjalë në mënyrë joserioze është marrë me këtë çështje, dhe nëse nuk janë profesional është dashtë të mos e pranojnë këtë detyrë, pasi që kjo po na kthen në pikën zero.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se duhet planifikuar në këtë vit që të ndërtohet një pus me hidrofor afër varrezave, dhe me një kujdestari të posaçme duke ujitur mund të eliminohet edhe kundërmimi, pasi që zhvendosja e pozitës së varrezave, do të krijojë shumë telashe.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- propozoi që kufomat të futen në kese speciale, të cilat mbyllen me zinxhir, si formë e eliminimit të kundërmimit.

Hajrulla Muli, anëtar i Kuvendit- tha se komisioni në fjalë ka identifikuar vendosje ilegale të mbeturinave në afërsi të varrezave, prandaj aty mund të kundërmojnë edhe mbeturinat që grumbullohen. Kurse lidhur me propozimin e S.Kadriut, tha se propozimi i tij është i paqartë(diskutabil) dhe është në kundërshtim me parimet e Fesë Islame.

Esat Beka, anëtar i Kuvendit- duke e mbështetur propozimin e kryetarit të komunës që varrezat të ujiten, tha, se në këtë mënyrë do të eliminohet kundërmimi, dhe shtoi se analizat e komisionit në fjalë janë të pasinqerta, pasi që nuk janë shtëpitë në largësi prej 300 m larg varrezave, por ka shtëpi prej 50 m larg varrezave.

Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit- tha se e kemi obligim ta verifikojmë gjendjen reale dhe ta zgjedhim këtë problem, duke shtuar se edhe komisioni në fjalë e ka lënë pezull këtë çështje, duke mos e kryer punën siç duhet, prandaj propozoi që problemin në fjalë ta verifikojnë ekspertë, dhe në bashkëpunim me përfaqësues nga Bashkësia Islame të zgjidhet problemi në fjalë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit- Grupi parlamentar i PDK-së i pranon konstatimet e komisionit në fjalë, duke e mbështetur votimin e tyre, kurse rekomandimet e tij nuk janë të nevojshme që të votohen, dhe të njëjtat kërkoi që të hiqen nga ky material, duke shtuar se e mbështesin propozimin e kryetarit të komunës për mirëmbajtjen e varrezave.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- Grupi parlamentar i LDK-së nuk e përkrah raportin e komisionit, pasi që është shumë kundërthënës(kontradiktor), por përkrah vendimin e mëparshëm të kuvendit për formimin e komisionit prej ekspertëve.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se për të dhënë një konstatim më të qëndrueshëm, komisioni në fjalë është dashtë të vizitojë vendin e ngjarjes më shumë herë, duke bërë një lloj eksperimenti në orare të ndryshme të ditës, për ta vërtetuar se ka apo nuk ka kundërmim.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- tha se është mirë që një komision profesional të bëjë një analizë, dhe shtoi se kur është propozuar si vend për varreza parapraakisht është dashtë të bëhet analiza e tokës, pastaj të vendosen varrezat. Gjithashtu propozoi që komuna të bëjë një projekt për mbjelljen e drunjve, të cilët duhet mirëmbajtur dhe ujitur, si dhe largimin e të gjitha deponive ilegale.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- tha se raporti në fjalë nuk përkrahet, prandaj do të votohet propozimi i kryetarit të komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më: 30.06.2011 ka shqyrtuar peticionin në fjalë, dhe pas shqyrtimit të hollësishëm, ka vendosur formimin e një komisioni profesional për të dalur në terren dhe për të analizuar për së afërmi gjendjen në varrezat në fjalë. Kurse, në seancën e datës 28.07.2011, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka analizuar raportin e komisionit, i cili në bazë të analizave të gjendjes në terren ka sjellur konkluzione dhe rekomandime për mënyrën e zgjidhjes së problemit, prandaj duke u bazuar edhe në raportin e komisionit, Komuna e Vushtrrisë në afatin optimal do të ndër marrë të gjitha masat e duhura për evitimin e problemit (shqetësimin) të banorëve të fshatit në fjalë.

11. Të ndryshme:

a. Propozim-vendimi që obligon bizneset për kryerjen e borxheve ndaj KRM-së "Uniteti", me rastin e aplikimit për leje të biznesit;

Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit- lidhur me propozim-vendimin në fjalë, tha se një vendim i tillë nuk ka bazë ligjore, sepse këto janë ndërmarrje publike, duke shtuar se kuvendi e ka borxh të mbrojtë interesat e qytetarëve, dhe tha se këto ndërmarrje i kanë grumbulluar(akumuluar) borxhet prej vitesh, kur dihet që kanë marrë edhe donacione, dihet se është paguar uji dhe pagat i kanë marrë me rregull. Kurse tani dëshirojnë që të shantazhojnë dhe kushtëzojnë disa të drejta dhe liri të qytetarëve, prandaj kërkojë që një vendim i tillë të mos miratohet.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se çështja në fjalë është e kundërligjshme, dhe duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nuk kemi të drejtë të marrim vendim të tillë. Pastaj tha se me një seriozitet më të madh të punëtorëve të kompanisë së lartpërmendur, nuk është i pamundur grumbullimi i mjeteve nga qytetarët për mbajtje më të mirë të higjienës. Ai njoftoi se Drejtoria e Shërbimeve Publike, por edhe vet si kryetar i komunës iu kanë ofruar mbështetje të jashtëzakonshme, por ata duhet të forcohen më tepër me punë dhe organizim, duke bërë plane të mira. Në fund tha se kushtëzimi i tillë nga kompania në fjalë, është një shantazhim ndaj qytetarëve.

Sami Istrefi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike- tha se nuk është antiligjore, dhe përderisa ligji nuk e precizon qartë një dispozitë ligjore, nuk mund të thuhet se është antiligjore. Pastaj tha se është tepër shqetësues menaxhimi i mbeturinave, dhe ka shumë kritika nga anëtarët e kuvendit për ekzistimin e deponive ilegale dhe se mungon një higjienë e mirë. Por asnjëherë nuk është shtruar si çështje se si komuna ta menaxhojë këtë problem të madh, dhe shtoi se Komuna e Vushtrrisë është e fundit që po e mendon ta marrë këtë vendim, pasi që të gjitha

komunat tjera e kanë marrë një vendim të tillë. Në vazhdim tha se ky vendim nuk do të mund të zbatohet, derisa këto mjete financiare nuk i menaxhon vet kompania e njësisë në Vushtrri, prandaj nëse nuk i mbështesim financiarisht, nuk kemi mundësi ta kemi një qytet të pastër. Gjithashtu tha se kompania në fjalë ka teknologjinë më të dobët. Në fund njoftoi se Ligji mbi mbeturinat është draft dhe pritet që kompanitë për menaxhimin e mbeturinave të kthehen nën menaxhim të komunave.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se nëse bëhen kompani komunale, atëherë është e arsyeshme edhe të kushtëzohen qytetarët, pasi që pastaj është kompani e jona.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- tha se ky vendim është i kundërligjshëm dhe prek direkt të drejtat e njeriut, pasi që kompanitë publike nuk janë nën menaxhim të komunës, dhe pyeti nëse ne i obligojmë qytetarët t'ua paguajnë tatimet, a mund ta obligojmë kompaninë t'iu ofrojë shërbime, çfarë shërbime t'iu ofrojë, dhe çfarë llogarie i jep kompania komunës për shërbimet e dobëta që ua bënë qytetarëve?, prandaj këto kompani duhet të bëhen kompani komunale, dhe atëherë ne edhe i menaxhojmë, edhe i përkrahim. Në fund tha se ndihma më e madhe që i ka bërë komuna kompanisë në fjalë është dhënia për menaxhim të mbeturinave, por nëse ata nuk mund të menaxhojnë mbeturinat e komunës, komuna ka të drejtë t'ia jep në menaxhim mbeturinat një kompanie private.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- i propozoi kryetarit të komunës që kur të vijnë propozim-vendimet të cilat nuk kanë bazë ligjore, të mos procedohen fare për shqyrtim në kuvend.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë nënpikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në shumicë votash vendosi me sa vijon:

Nuk aprovohet propozim-vendimi në fjalë, pasi që është i kundërligjshëm.

b.Kërkesë nga Drejtorja e Arsimit për transferimin e nxënësve në shkollat amë;

Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit- tha se kërkesa në fjalë nuk është e përgatitur siç duhet edhe për nga forma, dhe nuk është e proceduar mirë juridikisht, pastaj tha se këtu po bëhen dallime, pasi që janë marrë vetëm tri shkolla, kurse ka shkolla tjera edhe me më pak nxënës. Ka shkolla që i kanë vetëm 2 ose 3 nxënës, siç janë në: Zogaj, Vesekoc, Gumnishtë etj, prandaj është dashtë të bëhet një analizë dhe të mos bëhet në këtë mënyrë të ngutshme dhe të njëanshme, dhe në emër të Grupit parlamentar të AAK-së është kundër mënyrës së tillë.

Habib Mustafa, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar kërkesës në fjalë, tha se kjo është kërkesë për mbylljen e tri shkollave. Pastaj lidhur me shkollën në fshatin Beçuk, kërkoi që të mos aplikohet dhe të mos aprovohet një kërkesë e tillë siç ka kërkuar Drejtorja e Arsimit, duke paraqitur këto arsye: truallin për ndërtimin e shkollës e ka dhënë një qytetar; shkollën e kanë ndërtuar vet fshatarët, duke mos u ndihmuar me asnjë cent nga shoqëria; disponimi i qytetarëve të fshatit Beçuk pas rregullimit të rrugës është aq i madh, sa që disa familje po e shqyrtojnë mundësinë e kthimit në pronat e tyre. Mandej tha se nuk është real as numri i nxënësve që është paraqitur në kërkesën në fjalë, pasi që drejtorja e shkollës, por edhe kryetari i komunës është në dijeni se për shkak të rrugës, e cila ka munguar në Beçuk, është detyruar të paguajë transportimin e nxënësve që shkojnë në shkollën fillore prej Beçukut në paralelen e Gllavotinit. Në vazhdim duke iu referuar kërkesës në fjalë, lidhur me konstatimin se shkolla nuk i plotëson kushtet, tha se shkolla në Beçuk nuk është asgjë më keq se shkolla e Gllavotinit dhe shumë shkolla të tjera, të cilat nuk janë gëlqerosur që 7 – 8 vite. Kurse lidhur me arsyetimin se personeli arsimor nuk është i kualifikuar, tha se njëri mësues është i kualifikuar, kurse tjetri nuk është, që d.m.th se edhe ky konstatim nuk qëndron plotësisht, prandaj kërkoi që Kuvendi të mos e përkrah një kërkesë të tillë, dhe t'i jep mundësi edhe një vit të vlerësohet funksionimi i shkollës në Beçuk. Në fund tha se fshatarët i kanë ftuar në një tubim

organet gjegjëse për t'ua paraqitur argumentet e tyre, por këta të fundit nuk i janë përgjigjur takimit.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- lidhur me transportin e nxënësve të shkollës në Karaçë, tha se sivjet numri duhet të jetë 28 nxënës. Pastaj tha se disponimi i fshatarëve është që nxënësit të mos transportohen, pasi që një orë para kohe i sjellë kombi në shkollë, dhe një orë pas kohe i merr prej shkollës. Prandaj atyre po iu bie për të bredhur shumë rrugëve, dhe shtoi se është e padrejtë që një fshat me 50 familje të mbetet pa shkollë, por nëse personeli është i pakualifikuar, përmes konkursit të zëvendësohet me personel të kualifikuar. Në fund kërkoi që operatorëve që transportojnë nxënësit t'u tërhiqet vërejtja që ata t'iu përshtaten orarit të shkollës, duke shtuar se ata vijnë me vije të rregullt një orë para kohe, bredhin rrugëve, e presin kombin, kurse vija që është e paguar vetëm për transportin e nxënësve nuk respektohet, pasi që aty hyjnë edhe udhëtarë të tjerë. Prandaj duhet me qenë të kujdesshëm që të mos lejohet një dukuri e tillë, dhe nuk mund të barten përnjëherë 20 nxënës me një kombi, dhe është kundër që në këtë moment kjo kërkesë të aprovet.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar kërkesës në fjalë, tha se ne nuk jemi shkaktar të asaj gjendje që është krijuar nëpër fshatra, dhe shtoi se me numra kaq të vogël të nxënësve nuk ka shkollë të botë që funksionon, dhe në këto shkolla me numër kaq të vogël të nxënësve mungon edhe cilësia, prandaj për të mirën e këtyre nxënësve është që të vijnë në shkolla ku ka mësim më cilësor, ku bëhet punë dhe ku ka perspektivë, kurse kështu siç është gjendja tani, në të gjitha variantet jemi duke humbur.

Xhylsime Feka, anëtare e Kuvendit- tha se e përkrah kërkesën e Drejtorisë së Arsimit, pasi që është në dijeni se çfarë kushte janë në shkollën e fshatit Karaçë dhe në Studime, duke shtuar se në Karaçë objekti ku mbahet procesi mësimor nuk është shkollë, edhe në Studime është e njëjta gjendje, gjithashtu edhe cilësia mungon, prandaj kërkoi nga drejtori i arsimit që transporti i nxënësve të jetë më cilësor, sepse shqetësimi i qytetarëve të fshatit Karaçë është se si do të bëhet transporti i nxënësve, pasi që gjithmonë është dashtë që nxënësit të lëshojnë orën e fundit të mësimit, pritjet e gjata të kombibusit, ngarkimi i kombibusit edhe me udhëtarë të tjerë. Ndërsa, lidhur me njërin prej arsytiveve të Drejtorisë së Arsimit se personeli arsimor është i pakualifikuar, tha se kjo nuk qëndron, dhe nuk do të duhej të qëndronte, pasi që konkursi shpallet për çdo vit, me ç'rast konkurrojnë të kualifikuarit dhe të pakualifikuarit, prandaj duhet të zgjidhen të kualifikuarit.

Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim- tha se kërkesa e Drejtorisë së Arsimit është që të barten në shkollat amë, kurse shkollat tjera që kanë numër edhe më të vogël të nxënësve, është shkolla në Zogaj, që nuk ekziston më asnjë nxënës, dhe që 2 vite është e mbyllur. Pastaj tha se arsyeja e paraqitjes së kërkesës në fjalë ka ardhur si rezultat i reagimit të prindërve, pasi që prindërit nuk po pranojnë që fëmijët e tyre të transportohen, duke shtuar se shqetësimi i prindërve është i paarsyeshëm.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se është e nevojshme që të krijohet një politikë, e në veçanti për nxënësit e shkollës në Karaçë, pasi që objekti është në gjendje shumë të rëndë, prandaj edhe më herët i ka sugjeruar drejtorit të arsimit për të marrë vendim për bartjen e nxënësve, që të mos mbesin gjatës sezonës së dimrit në atë shkollë. Pastaj tha se nëse merret vendimi për transferimin e nxënësve në shkollat amë, kjo duhet të ndodh vetëm për shkak të cilësisë më të mirë të mësimit, e jo për ndonjë arsye tjetër, duke shtuar se numri i vogël i nxënësve dhe paralelet e kombinuara nuk japin cilësi. Gjithashtu tha se bartja e nxënësve tani nuk është problem, pasi që është rregulluar infrastruktura rrugore, kurse transportuesit e fëmijëve nëpër shkolla kanë përgjegjësi të madhe, dhe mund të monitorohen edhe nga policia dhe në forma tjera.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- tha se është problem të ketë cilësi në mësim me paralele të kombinuara, duke shtuar se tani është problem edhe kombinimi i klasëve, sepse shkolla fillore është me pesë klasë. Pastaj tha se transporti i nxënësve duhet kontrolluar nga inspektorët e komunës, dhe të kontrollojnë a e ka shenjë treguese që është duke transportuar nxënës të shkollave, dhe të kontrollohet se a kanë futur edhe qytetarë tjerë në kombibusët që duhet bartur vetëm nxënës.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- pyeti drejtorin e arsimit se a ka hulumtuar përvojat e komunave tjera, pasi që do të ishte mirë që të merren përvojat më të mira që ekzistojnë diku, dhe shtoi se është problem të ketë cilësi në mësim me paralele të kombinuara, prandaj kërkoi që kjo situatë të analizohet mirë, të merret në shqyrtim mendimi i prindërve dhe përvojat e të tjerëve.

Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim- lidhur me përvojat e komunave tjera, tha se jemi komuna e vetme që bëjmë transportimin e nxënësve, kurse edhe me Ligj dhe Udhëzim Administrativ kërkohet që shkollat në zona brenda 4 kilometrave të mos ketë paralele të ndara, e kurrësi mësim të kombinuar.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë nënpikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 15 vota “për”, 7 “kundër”, të tjerët “abstenim” me sa vijon:

Me këtë vendim lejohet transferimi i nxënësve në shkollat si vijon:

1.1 Nxënësit e paraleles së ndarë në Beçuk transferohen në shkollën në Stroc.

1.2 Nxënësit e paraleles së ndarë në Karaçë transferohen në shkollën “A.Z. Çajupi” në Vushtrri.

1.3 Nxënësit e paraleles së ndarë në Studime të Epërme transferohen shkollën në Studime të Poshtme.

c. Propozim-vendimi për ndihmë financiare ish-pjesëtarit të UÇK-së, Ekrem Shabani;

Safet Idrizi, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi- paraqiti sqarimet shtesë lidhur me propozim-vendimin në fjalë, dhe shtoi se është mirë që t’i ndihmohet rartit në fjalë aq sa kemi mundësi, por shumën e ndihmës nuk e kemi përcaktuar, pasi që shuma e faturës e rastit në fjalë është afër 20.000 €.

Bajram Mukalu, kryetar i Komunës- tha se Ekrem Shabani është ish-pjesëtar i UÇK-së, është plagosur gjatë një aksioni nga forcat serbe, dhe copat e fishekëve i kanë mbetë në trup, pastaj ka shkuar jashtë vendit dhe është operuar falë ndihmës së diasporës. Gjithashtu njoftoi se disa pjesë të fishekëve ia kanë hequr, por disa pjesë të tjera jo, atij i është rekomanduar që ta vazhdojë tretmanin, prandaj ka paraqitur kërkesë në Komunën e Vushtrrisë, dhe është mirë që Kuvendit t’i ndihmojë me mjete financiare rastit në fjalë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit- për rastin në fjalë, Grupi parlamentar i PDK-së propozon që t’i ndahet shuma prej 3.000 €.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë nënpikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime me sa vijon:

Ekrem Shabani (ish-pjesëtar i UÇK-së) i lejohen mjete financiare në shumën prej 3.000 € (tre mijë euro) nga buxheti i Komunës, fondi për transfere dhe subvencione.

ç. Shqyrtimi i ecurisë së punimeve në Kullën e Azem Bejtë Galicës.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- tha se me investimet e qeverisë komunale ka filluar ndërtimi i Kullës së Azem Bejtë Galicës në Galicë, mirëpo punimet nuk janë duke ecur mirë, dhe për një kohë komuna ia ka ndërprerë punimet një punëkryesi tjetër që ka qenë, për shkak të mos gatishmërisë për t’i kryer punimet ashtu si duhet, kurse tani punimet i ka vazhduar tjetër kompani, por edhe këta nuk janë duke punuar siç duhet, pasi që janë duke i zvarritur punimet, dhe propozoi që Drejtoria e

Urbanizmit, dhe Drejtoria e Kulturës ta kenë nën kontroll, duke i përcjellë punimet në vazhdimësi, derisa të përfundojë ndërtimi i Kullës në tërësi.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se pas vërejtjeve që janë bërë ndaj kompanisë për ndërtimin e kullës në fjalë, janë marrë masat e duhura, dhe kompania i ka ndërruar punëtorët, kështu që punimet janë duke vazhduar me një cilësi më të mirë.

Mbledhja përfundoi në orën 17:05.

Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi

Lektore:
Vlora Krasniqi